

Tirane, me

**AKTI I THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" DAMA-AL" SH.P.K.**

Sot, me date 13.03.2018, ditën e Marte, ora 12.00.

**1. Znj. Marisa Darra** e bija e Pietro Darra dhe Liliana Veronesi, datëlindja 02.01.1963, lindur ne Desenzano di Garda (Bs) Itali, dhe me banim ne Via Robert Baden Pawel, n. 57, Desenzano di Garda, shtetase italiane, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar, për identitetin e se ciles u sigurova nga dokumenti personal i saj, Karte Identiteti Nr.CA04458AL date lëshimi 21.10.2017 e vlefshme deri me date 02.01.2028,

**2. Z. Endrit Kazazi** i biri i Sefedin Kazazzi dhe Lejla Kazazi, datëlindja 30.04.1976, lindur ne Tirane, dhe me banim ne Tirane shtetas Shqiptar, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar, për identitetin e se cilit u sigurova nga dokumenti personal i tij, Karte Identiteti Nr H60430120L date lëshimi 17.05.2009 e vlefshme deri me date 16.05.2019,

Te cilët deklaruan se me dëshirën e tyre te lire dhe vullnet te plote dhe te pa vesuar se redaktojne kete Akt Themelimi te shoqërisë " DAMA-AL" sh.p.k. Ne Baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 1**

**THEMELIMI**

Formohet shoqëria " DAMA-AL" sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët e mundeshe te se njëjtës do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do te ketë selinë dega. Shoqëria do te ushtroje veprimtarinë e saj ne baze te këtij akti themelues dhe statutit te shoqërisë te miratuar nga ortaket.

**NENI 2**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë "Rruga Ibrahim Shalqizi, n. 9-1, Mjull Bathore, Komuna Farke, Tirane".

### **NENI 3**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i shoqërisë është:

Prodhim dhe perpunim veshjesh ne te gjitha format per llogari te vete ose per llogari te te treteve

Për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, shoqëria mund të autorizojë profesioniste ose ente të autorizuar për një ose me shumë aktivitete duke përpiluar marrëveshje të ndryshme.

Aktiviteti shoqërisë mund të zhvillohet nga ortakët ose nga punonjësit e/o bashkëpunëtorët nëpërmjet çfarëdolloj titulli.

Shoqëria mundet gjithashtu, të kryejë çfarëdolloj aktiviteti dytësor të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektit shoqëror mjafton të jenë aktivitete të lejuara nga ligji. Për këtë qëllim shoqëria mund të procedojë me blerjen, shkëmbimin, shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të kryera për arritjen e objektit të shoqërisë; të bëjë çdo lloj veprimi pranë bankave dhe instituteve të kreditit kombëtar ose ndërkombëtar, të bëjë tërheqje ose depozitime mbi llogarite aktive dhe pasive; të hapë llogari bankare dhe postale; të kryejë çdo operacion bankar.

Shoqëria mund të ngrejë njësi përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj, me ose pa depozite, të pranojë ose të lejojë interesa të përbashkëta, kuota dhe pjesëmarrje të shoqërive shqiptare ose të huaja me objekt të përbashkët, të përafërt ose të lidhur me të, pavarësisht nëse kanë lidhje direkte ose indirekte me këtë objekt.

### **NENI 4**

#### **MENYRA E KRYERJES SE AKTIVITETIT**

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të bashkëpunojë me persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj.

### **NENI 5**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **30 (tridhjetë) vjet**. Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) Tirane.

### **NENI 6**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqërisë tregtare private "DAMA-AL" sh.p.k. do të jetë 2.000 leke (dy mijë) dhe përbehet nga kuotat që i përkasin anëtarëve të shoqërisë, **ku një kuotë ka vlerë nominale 20 leke (njetete) leke**, si me poshtë vijon:

1. **Znj. Marisa Darra** zotëron 50% të kuotave, të barabarta me 1.000 lekë,
2. **Z. Endrit Kazazi** zotëron 50% të kuotave të barabarta me 1.000 lekë.

Kapitali fillestar i shoqërisë mund të shtohet ose pakësohet dhe është tërësisht i likuidueshem dhe i nënshkrueshem.

## **NENI 7**

### **SEKRETI I AKTIVITETIT**

Ortakët e shoqërisë angazhohen me detyrën për të shtuar volumin e veprimtarisë së shoqërisë, të respektojnë detyrimin e ruajtjes së sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar, si dhe marrin angazhim të mos themelojnë në Shqipëri aktivitete tjetër që të jete konkurrues me objektin e "DAMA-AL" sh.p.k.

## **NENI 8**

### **DREJTIMI I SHOQERISE**

Administratori i shoqërisë është **Z. Endrit Kazazi**, i cili ushtron të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme sipas parashikimeve të ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Administratori emërohet për një periudhë 5 (pese) vjeçare duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR, me të drejtë riemërimi për 5 (pese) vjet të tjera, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos për shkarkimin e tij një muaj para mbarimit të mandatit pese vjeçar, ose në rast se asambleja e përgjithshme e ortakeve nuk vendos revokimin e tij të parakohshëm sipas parashikimeve ligjorë, si dhe, në rast të dorëheqjes së parakohshme sipas procedurave të parashikuara me ligj.

## **NENI 9**

### **FITIMET**

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet.

## **NENI 10**



## ASAMBLEJA

**Asambleja e përgjithshme** emëron dhe revokon administratorin ne fuqi dhe mund te emëroje edhe administratore te tjerë me detyra te përcaktuara me ligj.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e ditëpërditshëm te shoqërisë, te përfaqësoje shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet me përjashtim te kompetencave qe vete ligji apo statuti ua jep shprehimisht ortakeve.

Për çështje te rëndësisë se veçante administratori konsultohet me ortaket dhe merr masat e përcaktuara nga asambleja e ortakeve, te marra me mazhorancat e parashikuara me ligj.

## NENI 11

### JURISDIKSIONI KOMPETENT

Për te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis palëve do te jete kompetent legjislacioni ne fuqi i Republikës se Shqipërisë. Juridiksioni kompetent do te jete gjykata e Tiranës.

## NENI 12

### VULA

Shoqëria ka vulën e vet dalluese me përmasa te zakonshme, te krijuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe mund te ketë një marke te sajën.

## NENI 13

### HYRJA NE FUQI E AKTIT TE THEMELIMIT

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanërisht te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

## NENI 15

### DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt-themelimi i shoqërisë "**DAMA-AL**" sh.p.k. u hartua ne baze te vullnetit te lire te themeluesve, ne mbështetje te dispozitave përkatëse te Kodit Civil , Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "**Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare**", te akteve te tjera ligjore dhe nënligjore te ligjit " Për Noterinë" dhe baze te nenit 51 te këtij ligji, hartohet ne 5 (pese) ekzemplare origjinale ne 5



(pese) faqe ku një qëndron pranë kësaj zyre dhe katër te tjera i dorëzohen ortakeve të shoqërisë.

**ORTAKET e SHOQERISE**

**" DAMA-AL "sh.p.k**

1. *Marina Dume*

2. *Lucretia Kama*